**BASHKIA HAS**

# RAPORTI TEKNIK

## *Objekti:* "RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9-VJEÇARE "SEJDI DIDA, QYTETI KRUMË, HAS"

## PROJEKT - ZBATIMI

**JANAR - 2025**

2Ð
PROJEKTIM
DESIGN
SUPERVISION
KOLAUDIM
Adresa: Rruga "Bardhyl" , Njesia Bashkiake nr. 8, T I R A N Ë

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK:

## Hyrje:

Kruma është një qytet që përfshin një sipërfaqe të mesme dhe shtrihet përgjatë disa komunave të Shqipërisë, duke përfshirë terrene të ndryshme. Zona ka një sipërfaqe të larmishme dhe është e ndarë në një grumbull krahinash të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën përmes grykave dhe luginave.

Relievi i Krumes është i shumëllojshëm, me zona kodrinore dhe male që mbulojnë pjesën më të madhe të këtij rajoni. Ka lartësi të ndryshme, dhe disa zona janë të thyer nga lumenj dhe grykat që krijojnë lëndina dhe hapësira të përshtatshme për bujqësinë.

Hidrografia e Krumës është e pasur, pasi zona kalon pranë lumenjve dhe përrenjve që sigurojnë ujë të freskët për zonën. Lumenjtë kryesorë që kalojnë në këtë rajon janë të lidhur ngushtë me formimin e ekosistemeve dhe mundësinë për zhvillimin e bujqësisë dhe të aktiviteteve të tjera.

Kruma ka një klimë mesdhetare, ku dimrat janë të butë dhe verërat e ngrohta. Pjesa perëndimore ka klima të ndryshme, ku terreni malor ndikon në variacione të temperaturave dhe reshjeve. Klimat e ngrohta janë të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë.

Numri i popullsi konsiderohet si nje numer mesatar, ku jane te shpërndarë në disa fshatra dhe qytete të vogla. Rritja e popullsisë ka ndodhur kryesisht për shkak të migracioneve dhe migrimit nga zonat e tjera.

Ekonomia e Krumës është e orientuar kryesisht nga bujqësia, duke përfshirë kultivimin e kulturave të ndryshme, si drithërat, perimet dhe frutat. Përveç bujqësisë, aktivitetet e tjera ekonomike përfshijnë blegtorinë dhe ndihmën e ekonomisë nga turizmi, sidomos për ato zona që janë të pasura me bukuri natyrore.

Megjithate ne na eshte kerkuar nga Bashkia Has te behet rikonstruktimi i objektit "Rikonstruksioni i shkolles 9-vjecare "Sejdi Dida" qyteti Krumë, Has".Me realizimin e ketij projektit, ne synojme qe shkolla te jete ne nivele te tilla ne menyre qe t'iu ofroje nxenesve kushte te standarteve europiane.

# Vendodhja :

Objekti “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare “Sejdi Dida” qyteti Krumë, Has”, ndodhet në Krumë në rrugën “Lidhja Prizrenit ” , përballë “Përmendorja e Pjetër Bogdanit”.Shkolla kufizohet nga njëra anë me kopshtin “1 Qershori” dhe nga ana tjetër me shkollën e mesme “Skënderbeu”.



# Gjendja Aktuale e Objektit:

Objekti që po trajtojmë në këtë raport teknik është "Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare "Sejdi Dida", qyteti Krumë, Has", e cila ka shumë vite që është ndërtuar dhe duke filluar nga viti i ndërtimit dhe deri më sot është rikonstruktuar shumë pak,kështu që gjendja aktuale e këtij objekti kërkon rikonstruktim të menjëhershëm.

Godina është e ndarë në katër kate.Cdo ambient në secilin kat ka nevojë për ndërhyrje të cila do të fillojnë që nga rregullimet për fasadën e brendshme,nevoja per rehabilitimin e elementëve si tavani, pllaka, dyer, dritare e jo vetëm.

Me përfundimin e të gjithë zërave të punimeve që kemi menduar, synojmë që të realizojmë një shkollë sa më funksionale dhe cilësore për nxënësit.

# Foto nga Gjendja Aktuale:



































# ZGJIDHJA E PROJEKTIT:

## Punimet për rikonstruktimin e objektit :

Projekti për rikonstruktimin e shkolles 9-vjecare "Sejdi Dida" është hartuar në bazë të kërkesës së Bashkisë së Hasit. Për zgjidhjen e këtij projekti sugjerohet rikonstruktim i domosdoshëm dhe i menjëhershëm i objektit që po trajtohet, rikonstruktim ky i cili duhet të sjell përmirësimin e kushteve për t'u hyrë në ndihmë nxenesve.

Eshtë menduar qe godines ti ofrohet nje lloj zgjidhje dhe do te kryen keto punime:

- Punime per prishje dhe pastrime;
- Punime hidroizolimi dhe shtresa;
- Punime per vendosje e dyer dritare;
- Punime per kanalizimet e brendshme si dhe te jashtme;
- Punime elektrike;
- Punime per instalimin e sistemit te mbrojtjes kundra zjarrit;
- Punime per instalim te sinjalizimit akustik;
- Punime per instalim i sistemit te atoparlanteve;
- Punime per instalimin e telefonise dhe internetit;
- Punime per kabina transformatorike;
- Punime per instalime elektrike ne kladaje;
- Punime per instalime per rrufeprites.

Pra, i gjithe objekti do te rikonstruktohet prej fillimit dhe secila prej punimeve te mesiperme jane shenuar ne menyre me te detajuar ne preventiv.

Sic e kemi shenuar mesiper nje nder punimet qe do te kryejme jane dhe shërbimet elektrike te cilat përfshijnë furnizimin me energji elektrike, shpërndarjen e energjisë, mbrojtjen nga sharkimet atmosferike dhe tokëzimin mbrojtës, ndricimi, sistemin e fuqisë sistemet e sigurisë dhe teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Ngarkesa elektrike e kërkuar për ndërtesën është llogaritur bazuar në kriteret e projektimit për ndriçimin, vendet e punës, ngarkesat e Paisjeve Audio të dhëna nga konsulenti përkatës, paisjeve meknaike dhe shërbimet e përgjithshme sipas tabelës së Analizës së ngarkesës .

Të gjitha sistemet elektrike dhe paisjet duhet të projektohen, prodhohen, instalohen, testohen dhe të porositen në përputhje me versionet e fundit të Standarteve Shqiptare, Evropiane dhe Ndërkombëtare, Legjislacioni dhe Direktivat e zbatueshme për këtë projekt.

Punimet elektrike janë bazuar në:

1. - Kërkesat e investitorit sipas detyrës së projektimit.
2. - Projektin arkitektonik dhe mobilimin e të dhëna nga arkitektura.
3. - Në të dhëna plotësues të mbledhura gjatë inspektimit në terren.
4. - Në kushtet teknike të projektimit, standartet e Republikës së Shqipërisë (KTP, STASH, ENSSH), Ligjet, VKM-të dhe rregulloret në fuqi si dhe kërkesat e OSHEE.
5.- Standarte, kode dhe rekomandime të organizatave ndërkombëtare si IEC, EEC, CEN/CENELEC, etj. si dhe standarte e kode disa të vendeve të BE-se si CEI dhe VDE.

Pajisjet duhet të jenë produkt i standartit të fundit të prodhuesit. Pjesët përbërëse duhet të jenë produkt i një prodhuesi të vetëm, përveç nëse miratohet ndryshe dhe me kusht që përbërësit e prodhuar nga prodhues të tjerë të jenë me një model standart dhe të jenë të këmbyeshëm. Prodhuesit duhet të jenë në gjendje të furnizojnë pajisje dhe materiale në përputhje me specifikimet.
Pajisjet përgjithësisht duhet të furnizohen në njësi të plota të asembluara nga fabrika të gatshme për instalim në vend. Ndarja e nevojshme për transport ose qëllime të tjera do të rregullohet për të kufizuar punën në terren në montimin e thjeshtë dhe ndër-instalimet e kabllove të kontrollit dhe energjisë.

*PLANI I KATIT PËRDHE*
*INSTALIMI I NDRIÇIMIT, PRIZAVE DHE FUQISË*



*PLANI I KATIT PARË*
*INSTALIMI I NDRIÇIMIT, PRIZAVE DHE FUQISË*




*PLANI I KATIT DYTË*
*INSTALIMI I NDRIÇIMIT, PRIZAVE DHE FUQISË*



*PLANI I KATIT PËRDHE*
*INSTALIMI I RRYMAVE TË DOBËTA*



*PLANI I KATIT PARË*
*INSTALIMI I RRYMAVE TË DOBËTA*



*PLANI I KATIT DYTË*
*INSTALIMI I RRYMAVE TË DOBËTA*



*PLANI I SHKOLLËS*

*TOKËZIMET DHE SHKARKIMET MBROJTËSE*




*HOLLËSI TË FIKSIMIT TË RRUFEPRITËSIT*



Sistemi i ngrohjes është një nga ata elementë të cilët futen tek komoditeti dhe kushtet që shkolla do t’iu ofrojë nxenesve dhe te gjithe stafit te punonjesve.Sistemi duhet të jetë i përshtatur për natyrën e hapësirës si dhe për fuksionet që do të kryej.Keshtu qe eshte menduar te perdoret ngrohja me kaldaje.

Pra, per instalimet e ngrohjes dhe specifikimet per systemin e ngrohjes:

-Tubacionet kryesore te ngrohjes do te jene prej materiali celik i zi pa tegel per sisteme ngrohje dhe te termoizoluar me termofleks.

-Tubacionet kryesore horizontale te ngrohjes do te kalojne ne kanale betoni te mbyllur ne katin perdhe.Kanalet do te jene me kapak betoni te armuar nen dysheme.

-Tubacionet kryesore vertikale, nga tubacionet kryesore horizontale deri tek kolektoret shperndares, do te kalojne ne mure te maskuar.

-Tubacionet shperndares, nga kolektoret deri ne aparatet ngrohese, do te jene prej bakri te termoizoluar me termofleks dhe lidhja me aparatet ngrohes, do te jene prej bakri te termoizoluar me termofleks dhe lidhja me aparatet ngrohese, do te jete me material celiku.

Gjate zbatimit te punimeve duhet patur kujdes per mos demtimin e tubacioneve.
Perpara venies ne pune sistemi i ngrohjes duhet te provohet sipas kushteve ne fuqi.

*PLANI I KATIT PËRDHE*
*INSTALIMET E NGROHJES*



*PLANI I KATIT PARË*
*INSTALIMET E NGROHJES*



*PLANI I KATIT DYTË*
*INSTALIMET E NGROHJES*



*PLANI I KATIT TË TRETË*

*INSTALIMET E NGROHJES*



*SKEMA E NGROHJES*



*PLANIMETRIA E DHOMËS SË KALDAJËS*




*PLANIMETRIA E TARRACËS SË KALDAJËS*



## FASADAT

Në fasadat e mëposhtme paraqiten vizualisht materialet e përdorura të objektit.

*FASADA, ANA JUG-PERËNDIMORE*



*FASADA, ANA VERI-LINDJE*



*FASADA, ANA VERI-PERËNDIM*




*FASADA, ANA JUG-LINDJE*



PRERJET

*PRERJA 1-1*



*PRERJA 2-2*



**PËRGATITI:**

**"2 ED" sh.p.k**

Drejtues Teknik:

**Ing. MARK PEMAJ**

Jeton Murra

Digitally signed by Jeton Murra
Date: 2025.03.05 10:26:03 +02'00'